

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, – kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Hashim Çollaku kryetar i kolegjit, Ferit Osmani dhe Shqipe Qerimi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor Bujar Ahmeti, në çështjen penale kundër të akuzuarit Xh.T. nga ..., Komuna e Gllogocit, për shkak të veprës penale rrezikim i Trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me ankesën e të akuzuarit Xh.T., të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, P.nr.693/2017, datë 19.01.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 25.05.2018, mori këtë

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit Xh.T., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Dega në Gllogoc, P.nr.693/2017, datë 19.01.2018, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Prishtinë – Dega në Gllogoc, me aktgjykimin P.nr.693/2017, të datës 19.01.2018, të akuzuarin Xh.T. nga ..., për shkak të veprës penale rrezikim i trafikut publik nga neni 378 par. 8 lidhur me par. 6 dhe par. 1 të KPRK-së, e ka shpallur fajtor dhe e ka gjykuar me dënim me burg në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajsh, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarit i është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej 600 (gjashtëqind)€, të cilën i akuzuari do ta paguaj në afat prej 15 ditësh, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, e në rast të mos pagimit të gjobës në afatin e caktuar, do të vuaj dënimin e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh. Është obliguar i akuzuari që në emër të shpenzimeve procedurale të paguaj shumën në lartësi prej 90.88 €, dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 30 €, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore juridike për kompensimin e dëmit të shkaktuar janë udhëzuar në kontest civil.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur i akuzuari Xh.T., për shkak të vendimit mbi lartësinë e dënitimit me burg efektiv, me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, dhe pas shqyrtimit të ankesës të shqiptoj një dënim më të butë.

Prokurori i Apelit, me parashtrësën me shkrim PP/II.nr.514/2018, datë 16.05.2018, ka propozuar që të refuzohet si e pa bazuar ankesa e të akuzuarit Xh.T., e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore Prishtinë – Dega në Gllogoc, P.nr.693/2017, datë 19.01.2018, ashtu që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit pasi shqyrtoj të gjitha shkresat e kësaj çështje juridiko-penale, studioj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 të KPPK-së, dhe pas vlerësimeve të pretendimeve në ankesë, gjeti se:

Ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk animohet për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë Gjykata e Apelit të njëjtin sipas detyrës zyrtare e shqyrtoj edhe në këtë aspekt, konform dispozitës së nenit 394 të KPPK-së dhe konstatoj se ai nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, e të cilat do të kushtëzonin anulimin e tij, si dhe as shkelje të Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi e kësaj gjykate, ngase në ankesë nuk ka mundur të kontestohet, sepse i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor e ka pranuar fajësinë për të gjitha pikat e akuzës, edhe gjykata është pajtuar me një pohim të tillë, prandaj sipas nenit 383 par. 2 të KPPK-së, ndaj aktgjykimin që është marrë në bazë të pranimit të fajësisë ose marrëveshjes për pranimin e fajësisë nuk lejohet ankesa për gjendjen e fakteve, aktgjykimi i ankimuar u vlerësua vetëm në frymën e pretendimeve ankimore sa i përket vendimit për dënim.

I akuzuari ankesën e tij e ankimon sa i përket vendimit mbi lartësinë e dënimit me pretendimin se gjykata e shkallës së parë edhe pse i ka përmendur rrethanat lehtësuese nuk i ka analizuar ato në mënyrë të drejtë në rastin e shqiptimit të sanksionit penal duke i shqiptuar dënim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Edhe pse është thirrur se ka pasur për bazë rrethanat lehtësuese gjatë shqiptimit të dënimit, por konsideroj se më tepër ka bërë evidentimin e rrethanave lehtësuese dhe kështu e njëjta nuk ka vendosur në mënyrë të drejtë gjatë shqiptimit të dënimit. Sipas tij gjykata nuk pati parasysh faktin se me palën e dëmtuar janë vëllezër dhe se nuk ka menduar asnjëherë që atë ta vej në rrezik të humbjes së jetës, që fatmirësisht ka shpëtuar por me lëndime të rënda, dhe se këtë gjë po e përjetoj me dhimbje të madhe që nuk mund të përshkruaj. Ai theksoi se edhe pse e ka pranuar veprën, për të cilën është penduar aq thellë asnjë dënim tjetër qoftë më i lartë nuk do të kishte me ndikuar më shumë sesa dhembja që po e përjeton dhe ndërjegjja e tij për lëndimet e pa qëllimshme që ju ka shkaktuar të dëmtuarve dhe fillimisht edhe vëllait të tij. Nga të gjitha këto, i propozon gjykatës që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të njëjtit të i shqiptohet dënim më i butë.

Sipas vlerësimit të kësaj gjykate, pretendimet e të akuzuarit, për shqiptimin e një dënimi më të ulët është i pa bazuar. Gjykata e shkallës së parë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit siç parashihen me dispozitat e nenit 73 të KPRK-së, ashtu që si rrethana lehtësuese për të akuzuarin, gjykata ka marrë pranimin e fajësisë, se më parë nuk ka qenë i dënuar për ndonjë veprë penale, faktin se të dëmtuarve i'u ka kërkuar falje, premtimin e tij se në të ardhmen nuk do ti kryej vepra penale, pendimin e tij, gjendjen e tij ekonomike, se është i pa punë, i martuar, baba i tre fëmijëve të mitur dhe faktin se pikërisht në

këtë aksident lëndime të rënda trupore ka pësuar edhe vëllau i tij, ndërsa si rrethana rënduese gjykata gjeti se shkalla e demit të shkaktuar është e lartë dhe se kemi një të lënduar rëndë si dhe dy të lënduar lehtë, andaj edhe pse për këtë veprë është i paraparë dënimi me burgim prej 6 muajsh deri në 5 (pesë) vjet, të njëjtit i shqiptoj dënim me burg si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar. Kolegji penal i kësaj gjykate vlerëson se pas vërtetimit të fakteve dhe provave në mënyrë të drejtë gjykata e shkallës së parë me aplikimin e dispozitave ligjore të akuzuarit i ka shqiptuar dënim i cili është në pajtim me peshën e veprës penale, pasojat e shkaktuara dhe se i morri parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese, e të cilat sipas vlerësimit të kësaj gjykate i vlerësoi në mënyrë meritore, ndërsa në ankesën e të akuzuarit nuk paraqitet ndonjë rrethanë e re lehtësuese, e e cila do të ndikonte që aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet në favor të të akuzuarit duke i shqiptuar të njëjtit dënim më të ulët, e duke i marrë parasysh rrethanat lehtësuese të konstatuara dhe vlerësuara nga gjykata e shkallës së parë, si dhe faktin se i akuzuari në shqyrtimin gjyqësor ka dhënë pëlqimin që dënimi me burgim në kohëzgjatje prej 6 muajsh, të i zëvendësohet në dënim me gjobë, kjo gjykatë vlerëson se dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë është në harmoni me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit si ekzekutor dhe me intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur, e posaçërisht duhet të jetë në funksion të preventives gjenerale dhe individuale, forcimit të moralit të shoqërisë si dhe përgjegjësisë dhe disiplinës së qytetarëve dhe se me dënimin e shqiptuar kryerësi do të parandalohet nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, do të bëhet rehabilitimi i tij dhe do të ndikoj në përmbajtjen e personave tjerë nga kryerja e veprave penale, kjo gjykatë konsideron se me dënimin e shqiptuar të akuzuarit nga gjykata e shkallës së parë do të arrihet edhe qëllimi i ndëshkimit i paraparë me dispozitat e neni 41 të KPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të nenit 401 të KPPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS

PA1.nr.508/18, datë 25.05.2018

Zyrtari ligjor
Bujar Ahmeti

Kryetari i kolegjit
Hashim Çollaku

Anëtarët e kolegjit:

Ferit Osmani
Shqipe Qerimi